

1. Kontakti	
1.1. Organizata kontaktuese:	Agjencia e Statistikave të Kosovës - ASK
1.2. Njësia kontaktuese në organizatë:	Departamenti i Statistikave Sociale - Sektori i Tregut të Punës
1.3. Emri i kontaktit:	Bujar Hajrizi
1.4. Funkzioni i personit kontaktues:	Udhëheqës i sektorit të tregut të punës
1.5. Adresa e postës kontaktuese:	Rruga “Zenel Salihu” no 4. 10000 Pristina, Kosovo
1.6. Adresa e emailit kontaktues:	bujar.r.hajrizi@rks-gov.net
1.7. Numri kontaktues:	+ 381 38 200 31 141
1.8. Numri kontaktes i faksit:	Nuk ka numër të faksit në dispozicion. Numri i faksit është i përgjithshëm: +381 38 235 033

2. Prezantimi i statistikave	
2.1. Përshkrimi i të dhënave:	Objektivat kryesore të Anketës së Fuqisë Punëtore janë grumbullimi i informatave kryesisht për anën e ofertës së tregut të punës, d.m.th. Informatave mbi ata që punojnë apo që janë aktivë në kërkim të një pune. Anketa siguron të dhëna lidhur me popullsinë sipas moshës, arsimit, statusit të punësimit, shkallës së varësisë, shkallës së aktivitetit; Punësimi sipas moshës, arsimimit, aktivitetit ekonomik, profesionit, statusit profesional, kushteve, orëve të punës; Papunësia sipas moshës, arsimit, kohëzgjatjes, metodave të kërkimit, përvojës së mëparshme të punës, aktivitetit ekonomik, profesionit; Joaktiv sipas moshës dhe nga arsimimit.
2.2. Sistemi i klasifikimit:	AFP mbledh informacion mbi profesionin sipas sistemit ndërkombëtar të Klasifikimit të Profesioneve (ISCO 88) dhe për aktivitetet ekonomike sipas Klasifikimit Evropian të Aktiviteteve Ekonomike (NACE Rev.2) dhe Sistemin Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (ISCED 97).
2.3. Mbulimi nga sektori:	Mbulon të gjithë sektorët ekonomikë. Tabelat e punësimit prezantojnë punësimin dhe papunësinë sipas aktiviteteve ekonomike dhe profesionit.
2.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet:	<p>Popullsia në moshë pune përfshin personat e moshës 15 deri 64 vjeçare. Kjo masë përdoret për të dhënë një vlerësim të numrit të përgjithshëm të punonjësve potencialë brenda një ekonomie.</p> <p>Fuqia punëtore përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë, sipas përkufizimeve të sakta, të paraqitura mëposhtëm. Personat joaktivë nuk konsiderohen pjesë e fuqisë punëtore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të punësuar: personat, të cilët gjatë javës referente kanë bërë ndonjë punë për pagesë, fitim ose përfitim familjar, në të holla ose në natyrë, ose ata që mungonin përkohësisht në punën e tyre. 2. Të papunë: personat, të cilët gjatë javës referente: <ul style="list-style-type: none"> • Ishin pa punë, d.m.th. nuk ishin të punësuar me pagesë ose të vetëpunësuar; • Aktualisht ishin të gatshëm për punë, d.m.th. ishin të gatshëm të fillojnë punë me pagesë ose vetëpunësim brenda dy javësh; dhe • Kërkonin punë, d.m.th. kishin ndërmarrë hapa specifike gjatë katër javëve të fundit në kërkim të punësimit me pagesë ose vetëpunësimit. 3. Persona joaktivë: personat, të cilët gjatë periudhës referente nuk ishin as të punësuar as të papunë.

2.5. Njësia statistikore:	Ekonomitë familjare dhe anëtarët e ekonomisë familjare.
2.6. Popullsia statistikore:	Popullsia e synuar në çdo vend përbëhet nga të gjithë personat që jetojnë në ekonomi familjare private. Personat që jetojnë në ekonomi familjare kolektive dhe në institucione në përgjithësi janë të përjashtuar nga popullsia e synuar.
2.7. Zona referuese:	Kosova (niveli kombëtar).
2.8. Mbulimi kohor:	Seritë kohore janë në dispozicion nga viti 2001 deri në vitin 2009, 2012-2016.
2.9. Periudha bazë	Nuk ka indeks të përdorur.

3. Përpunimi statistikor

3.1. Burimi të dhënave:	<p>Të dhënat janë bazuar në anketë.</p> <p>Korniza e mostrës u bazua në të dhënat dhe hartografi nga Regjistrimi 2011. Për qëllime të numërimit nga ana e regjistrimit, Kosova ishte ndarë në Zona Regjistruese (QR), të cilat janë segmente relativisht të vogla operative të përcaktuara për numërimin e regjistrimit. Një total prej 4626 QR janë përcaktuar për Kosovë dhe këto u përdorën si njësi primare të mostrës (NJZP) të përzgjedhura në fazën e parë të marrjes së mostrave për AFP. Një total prej 600 QR mostër janë përzgjedhur për vitin 2017 AFP të Kosovës çdo tremujor, janë ndarë për shtresa proporcionale me numrin e ekonomive familjare. Brenda çdo mostre QR 8 familje mostër janë përzgjedhur në fazën e dytë, për një madhësi totale të mostrës prej 4,800 familje për çdo tremujor.</p>
3.2. Shpeshësia e mbledhjes së të dhënave:	<p>Mbledhja e të dhënave është vjetore 2001-2009.</p> <p>Me 2010-2011 - nuk ka pasur anketë.</p> <p>Prej vitit 2012 dhe në vazhdim është mbledhja e të dhënave javore "52 javë në vit".</p> <p>Nga viti 2016 anketa ka filluar të publikohet në baza tremujore.</p>
3.3. Mbledhja e të dhënave:	<p>Për periudhën 2001 - 2009 për të mbledhur të dhëna për intervistë është përdorur Intervistë personale e asistuar në letër (PAPI).</p> <p>2012 e në vazhdim për të mbledhur të dhëna në intervistë u përdor intervista personale e asistuar në kompjuter (CAPI).</p>
3.4. Vlefshmëria e të dhënave:	<p>Vendbanimet e ndara në zona më të vogla quhen qarqe regjistruese. Çdo muaj 7 zyrat rajonale kontrollojnë të paktën një qark regjistruese me 4 familje nëse intervistuesi ishte në familje dhe ata nuk janë duke shkuar për të plotësuar krejt pyetësorin por pyetjet kryesore rreth të punësimit-papunësisë, profesioneve arsimimit, orët e punës. Ata dërgojnë të dhënat në zyrën kryesore ku bëhet krahasimi i asaj që merret nga intervistuesi dhe nga zyra rajonale. Gjithashtu Zyra kryesore bënë të njëjtën gjë dhe ndonjëherë ato thërrasin familjet me telefon në qoftë se dyshojnë për çdo të dhënë.</p>
3.5. Hartimi i të dhënave:	<p>Ndonjëherë neve kemi mungesë të kodit të aktivitetit (NACE Rev.2) dhe Profesioneve (ISCO 88) dhe nganjëherë kodet nuk korrespondojnë me pjesën tjetër të informacionit. Në këto raste kodet numërohen në bazë të njohurive të ekspertëve.</p> <p>Llogaritja e peshave themelore: Pësia bazë për çdo familje mostër do të jetë e barabartë me probabilitetin e saj të zgjedhjes (llogaritjet duke shumëzuar probabilitetet në secilën fazë të mostrimit). Një peshë familje do t'i bashkëngjitet çdo rekordi të mostrës familjare në dosjet e të dhënave. Probabilitetet e mostrës në secilën fazë të përzgjedhjes duhet të mbahen në një Excel faqe me</p>

	informacione nga korniza e mostrës për secilin QR të mostrës, në mënyrë që probabilitetet e përgjithshme dhe peshat përkatëse të mund të llogariten. Probabilitetet e përzgjedhjes janë të bazuara në shtresimin e dizajnuar me dy faza të mostrës. Në fazën e parë, një mostër e QR-ve u përzgjedh me probabilitet të barabartë brenda çdo shtresë (rajon, urbane/rurale), dhe në fazën e dytë një mostër prej 8 familjeve është përzgjedhur në secilin QR të mostrës. Kalkulimin e peshave të AFP për çdo tremujor: Peshat bazë tremujore janë llogaritur duke përdorur formulën për peshën e specifikuar në seksionin e mëparshëm. Megjithatë, peshat për çdo tremujor do të ndryshojnë bazuar në numrin e fundit të QR mostër të renditura dhe numrin e familjeve mostër me intervista të kompletuara në çdo QR të mostrës.
3.6. Përshatja/rregullimi:	Rregullimi/përshatja e AFP 2017 tremujore bazuar në projeksionet e popullsisë: Prandaj u vendos për të rregulluar peshat e AFP për çdo tremujor duke përdorur projeksionet ose parashikimet e popullsisë totale në Kosovë për mesin e vitit 2016 bazuar në teknikat e demografisë. Kjo gjithashtu do të bëjë vlerësimin e peshuar të popullsisë së përgjithshme duke përdorur peshat vjetore në përputhje me popullsinë totale të projektuar.

4. Menaxhimi i cilësisë	
4.1. Sigurimi i cilësisë:	ASK është e angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në "LIGJIN Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS", ASK përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të saj, ASK ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). ASK ka zhvilluar një Deklaratë të Cilësisë e cila gjendet në faqen e internetit të ASK-së: http://ask.rks-gov.net/media/1889/deklarata-e-cilesise.pdf . Dokumenti përmban njëmbëdhjetë parime, në përputhje me parimet e CoP, si pavarësia profesionale dhe konfidencialiteti statistikor, në të cilat bazohet puna e ASK-së.
4.2. Vlerësimi i cilësisë:	Gjatë vitit 2017 Në Agjencinë e Statistikave të Kosovës është kryer procesi i vlerësimit të Sistemit Statistikor të Kosovës përmes qasjes "Peer Review".

5. Relevanca	
5.1. Nevojat e përdoruesit:	Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Tregtisë, dhe institucionet ndërkombëtare.
5.2. Kënaqshmëria e përdoruesit:	Njëra ndër elementet kyçe për të siguruar cilësinë e të dhënave statistikore është matja e kënaqshmërisë së përdoruesve. Anketa ka për qëllim që të grumbulloj informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve dhe shfrytëzuesve të të dhënave zyrtare statistikore. Me anë të kësaj ankete shfrytëzuesit e të dhënave statistikore kanë shprehur mendimet dhe opinionet e tyre lidhur me pikëpamjet statistikore, kanë dhënë këshilla dhe sugjerime lidhur me nevojat e tyre për statistika si dhe për përmirësimin e këtyre të dhënave statistikore në të ardhmen. Këtë vit u zhvillua për herë të dytë Anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve. Qëllimi i këtij ankete është të matë nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve të të dhënave dhe të kemi informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve. Pyetëtori u plotësua nga 34 përdorues, të përbërë nga

	14 pyetje. Rezultatet e këtij studimi do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të ASK-së.
5.3. Plotësia:	AFP u ndërtua në bazë të rregullores ndërkombëtare. Disa variabla nuk janë në përputhje me standardet e BE-së të AFP-së për shkak se Kosova nuk është e ndarë në rajonet NUTS.
5.3.1. Data completeness - rate	Shkalla e mbulueshmërisë është 94,8%.

6. Saktësia dhe besueshmëria

6.1. Saktësia e përgjithshme:	Anketa e Fuqisë Punëtore mbulon personat që jetojnë në ekonomitë familjare private. Ndërsa rezultatet bazohen në një mostër të popullsisë, ato i nënshtrohen llojeve të zakonshme të gabimeve që lidhen me teknikat e nxjerrjes së mostrave dhe intervistave, siç janë gabimet e nxjerrjes së mostrave, gabimet gjatë fazës së intervistimit, gabimet e matjes, gabimet e përpunimit dhe mosgjigjet.																																
6.2. Gabimi në mostra:	<p>Efekti i rastësishëm për shkak të mostrimit do të thotë se rezultatet e llogaritura nga mostra të ndryshme devijojnë disi nga njëri-tjetri. Shifrat e të punësuarve dhe të papunëve, që janë nxjerrur të bazuara në një mostër më madhe dhe më representative janë më të sakta sesa ato që bazohen në mostra më të vogla.</p> <p>Pasaktësia për shkak të dizajnit dhe përzgjedhjes së mostrës vlerësohet me gabimin standard të vlerësimit. Madhësia e gabimit standard ndikohet nga madhësia e mostrës dhe varianca e variablave që janë objekt studimi. Gabimi standard mund të përdoret për të llogaritur intervalin e besimit, brenda të cilit vlera e popullsisë qëndron me një probabilitet të caktuar. Shkalla e punësimit, shkalla e papunësisë si dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është prezantuar në tabelën më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kosovo TM2 2017</th> <th rowspan="2">Përqindje (%)</th> <th rowspan="2">Devijimi standard</th> <th colspan="2">Intervali i besueshmërisë</th> <th rowspan="2">CV</th> </tr> <tr> <th>I ulët</th> <th>I lartë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)</td> <td>29,9</td> <td>0,6</td> <td>28,6</td> <td>31,1</td> <td>2,2</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e papunësisë</td> <td>30,6</td> <td>0,8</td> <td>29,0</td> <td>32,3</td> <td>2,7</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore</td> <td>43,0</td> <td>0,7</td> <td>41,6</td> <td>44,4</td> <td>1,7</td> </tr> </tbody> </table>	Kosovo TM2 2017	Përqindje (%)	Devijimi standard	Intervali i besueshmërisë		CV	I ulët	I lartë	Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	29,9	0,6	28,6	31,1	2,2	Shkalla e papunësisë	30,6	0,8	29,0	32,3	2,7	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	43,0	0,7	41,6	44,4	1,7						
Kosovo TM2 2017	Përqindje (%)				Devijimi standard	Intervali i besueshmërisë		CV																									
		I ulët	I lartë																														
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	29,9	0,6	28,6	31,1	2,2																												
Shkalla e papunësisë	30,6	0,8	29,0	32,3	2,7																												
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	43,0	0,7	41,6	44,4	1,7																												
6.2.1. Gabimi në mostra - treguesit	<p>Disa indikatorë janë prezantuar në tabelën në vijim:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Numri i personave të punësuar</th> <th>Shkalla e punësimit si përqindje e popullsisë</th> <th>Numri i personave të punësuar me kohë të pjesshme</th> <th>Numri i personave të papunësuar</th> <th>Shkalla e papunësisë si përqindje e fuqisë punëtore</th> <th>Shkalla e papunësisë së të rinjve si përqindje e fuqisë punëtore</th> <th>Mesatarja e orëve aktuale të punës në javë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>CV</td> <td>1,80%</td> <td>1,55%</td> <td>7,89%</td> <td>3,10%</td> <td>2,69%</td> <td>3,78%</td> <td>0,26%</td> </tr> <tr> <td>SE</td> <td>6398</td> <td>0,53%</td> <td>1689</td> <td>4915</td> <td>0,83%</td> <td>1,93%</td> <td>0,362709</td> </tr> <tr> <td>CI**</td> <td>[336812; 361943]</td> <td>[33,32; 35,42]</td> <td>[18076; 24710]</td> <td>[148414; 167720]</td> <td>[29,03%; 32,27%]</td> <td>[47,10%; 54,65%]</td> <td>[43,34; 44,36]</td> </tr> </tbody> </table>		Numri i personave të punësuar	Shkalla e punësimit si përqindje e popullsisë	Numri i personave të punësuar me kohë të pjesshme	Numri i personave të papunësuar	Shkalla e papunësisë si përqindje e fuqisë punëtore	Shkalla e papunësisë së të rinjve si përqindje e fuqisë punëtore	Mesatarja e orëve aktuale të punës në javë	CV	1,80%	1,55%	7,89%	3,10%	2,69%	3,78%	0,26%	SE	6398	0,53%	1689	4915	0,83%	1,93%	0,362709	CI**	[336812; 361943]	[33,32; 35,42]	[18076; 24710]	[148414; 167720]	[29,03%; 32,27%]	[47,10%; 54,65%]	[43,34; 44,36]
	Numri i personave të punësuar	Shkalla e punësimit si përqindje e popullsisë	Numri i personave të punësuar me kohë të pjesshme	Numri i personave të papunësuar	Shkalla e papunësisë si përqindje e fuqisë punëtore	Shkalla e papunësisë së të rinjve si përqindje e fuqisë punëtore	Mesatarja e orëve aktuale të punës në javë																										
CV	1,80%	1,55%	7,89%	3,10%	2,69%	3,78%	0,26%																										
SE	6398	0,53%	1689	4915	0,83%	1,93%	0,362709																										
CI**	[336812; 361943]	[33,32; 35,42]	[18076; 24710]	[148414; 167720]	[29,03%; 32,27%]	[47,10%; 54,65%]	[43,34; 44,36]																										
6.3. Gabim jo-i mostrave:	Gabimet e jo të mostrave janë gabimi që ka ndodhur gjatë fazave të tjera të anketimit të cilat janë: Gabimi i mbulimit që janë divergjencat ndërmjet kornizës dhe popullatës së synuar. Gabimet që ndodhin gjatë grumbullimit të të dhënave, gabimet gjatë përpunimit dhe gabimi i mos përgjigjeve kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve.																																

6.3.1. Mbulimi i gabimit	Gabimet e mbulimit përfshijnë si mbi mbulimin ashtu edhe nën mbulimin e gabimeve. Korniza e fundit e ekonomive familjare është nga Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 dhe ekonomite familjare nuk janë të prezantuara shumë mirë dhe gabimet mund të ndodhin për shkak të dallimeve ndërmjet kornizës dhe popullatës së synuar. Gabimi i nën mbulimit është nese njësitë e popullatës së synuar nuk janë të qasshme nëpërmjet kornizës dhe ato gabime janë të vështira për t'u matur. Gabimi mbi mbulimin janë njësitë e gabimit të arritshme nëpërmjet kornizës që nuk i përkasin popullatës së synuar. Fokusi kryesor është në mbi mbulimit e gabimeve.								
6.3.1.1. Mbi-mbulimi – norma, shkalla	Mbi mbulimi përmban ekonomite familjare të cilat janë të zbrazëta, shtëpitë që janë shkatërruar etj. Shkalla e mbi mbulimit është rreth 8,5% e ekonomive familjare.								
6.3.1.2. Njësitë e përbashkëta - proporcioni	Nuk është në dispozicion.								
6.3.2. Gabimi në matje	Të dhënat mblidheshin përmes Intervistës Personale të Asistuar me Kompjuter (CAPI) dhe gabimet për shkak të pyetësorit janë pothuajse të eliminuara.								
6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje	Gabimet e mos përgjigjes janë gabimet kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve. Gabimet e mos përgjigjeve janë kategorizuar në tre grupe kryesore: Refuzim, familjet që nuk janë kontaktuar dhe në grupin e tretë përfshihen të tjera të cilat për ndonjë arsye tjetër nuk janë kontaktuar.								
6.3.3.1. Njësia jo-përgjigje - norma për P	Shkalla e papeshuar e mos përgjigjes është 18,44%, refuzimet dhe kategoritë e tjera të mos përgjigjes janë paraqitur në tabelën më poshtë:								
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Shkalla e mos përgjigjes (%)</th> <th>Refuzime (%)</th> <th>Jo të kontaktuar (%)</th> <th>Të tjera (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>18,44</td> <td>6,53</td> <td>9,02</td> <td>2,89</td> </tr> </tbody> </table>	Shkalla e mos përgjigjes (%)	Refuzime (%)	Jo të kontaktuar (%)	Të tjera (%)	18,44	6,53	9,02	2,89
Shkalla e mos përgjigjes (%)	Refuzime (%)	Jo të kontaktuar (%)	Të tjera (%)						
18,44	6,53	9,02	2,89						
6.3.3.2. Artikulli jo-përgjigje - norma për P	Nuk është në dispozicion.								
6.3.4. Gabimi në përpunim	Gabimi gjatë përpunimit të të dhënave kryesisht janë për shkak të aspekteve teknike etj.								
6.3.4.1. Norma e Imputimit	Nuk është në dispozicion.								
6.3.5. Gabimi në supozim të modelit	Nuk është në dispozicion.								
6.4. Rishikimi i të dhënave	Nuk është në dispozicion.								
6.5. Rishikimi i të dhënave - politika:	Në ASK nuk ka politika të rishikimit.								

6.6. Rishikimi i të dhënave - praktika:	Nuk është kryer asnjë rishikim.
6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare	Nuk është në dispozicion.

7. Afati kohor dhe përpikëria	
7.1. Afati kohor:	Që nga viti 2016 të dhënat publikohen në baza tremujore. Periudha referuese për TM2 2017 është 1 prill – 30 qershor 2017.
7.1.1. Vonesat në kohë – rezultatet e para	Nuk është në dispozicion.
7.1.2. Vonesat në kohë – rezultatet përfundimtare për P	Rezultatet e anketës publikohen me 6 tetor 2017. Vonesa në kohë është 98 ditë (T+98) për TM2 2017.
7.2. Përpikëria:	Të dhënat e AFP TM2 2017 janë publikuar në kohë.
7.2.1. Përpikëria - ofrimi dhe publikimi për P	Vonesa në kohë është 0.

8. Koherenca dhe krahasueshmëria	
8.1. Krahasueshmëria - gjeografike:	Statistikat i referohen vetëm nivelit kombëtar.
8.1.1. Asimetria për pasqyrën e rrjedhës së statistikave - koeficienti	Nuk është në dispozicion.
8.2. Krahasueshmëria nëpër kohë:	Anketa ishte vjetore që nga viti 2001- 2009 të dhënat janë mbledhur kryesisht në shtator dhe organizimi në terren ishte 21 ditë. Krahasueshmëria është që nga viti 2001 - 2009. Nuk ka anketë për vitin 2010 dhe 2011. Që nga janari 2012 dhe në vazhdim anketat vijuese ishin 52 javë në vit që janë javë e referencës. Java referuese është java e anketuar më herët. Vit është i ndarë në 4 tremujorë dhe tremujori është i ndarë në 13 javë. Krahasueshmëria është që nga viti 2012 e tutje. Nga 2016 të dhënat publikohen në baza tremujore.
8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme për P	Krahasueshmëria është nga 2001-2009. CC2=9. Krahasueshmëria është nga 2012-2016. CC2=5.
8.3. Koherenca – fushat e ndërlidhura:	Anketat e ekonomive familjare janë duke përdorur të njëjtin përkufizim për urban/rural. Gjithashtu i njëjti është përdorur për klasifikimin e aktivitetit ekonomik dhe të profesionit.
8.4. Koherenca – statistikat gjysmë-vjetore dhe vjetore	Nuk është në dispozicion.
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare	Nuk është në dispozicion.

8.6. Koherenca - e brendshme:	Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.
-------------------------------	---

9. Qasja dhe qartësia

9.1. Njoftimet për shtyp:	Njoftimet për shtyp janë on-line në kohën e shpërndarjes së të dhënave. Paraqitet një përshkrim i shkurtër në lidhje me shkallen e punësimit dhe të papunësisë.
9.2. Publikimet:	Publikimet e ASK-së, tabelat dhe materialet për njoftim për shtyp, janë gjithmonë në dispozicion në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.
9.3. Baza e të dhënave online:	ASK ka bazën e të dhënave online: http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/?rxid=48d7fed2-90d9-4873-8854-c1e793ecafad .
9.3.1. Tabelat e të dhënave - konsultimet	Nuk është në dispozicion.
9.4. Qasja në mikro-të dhënat:	Përdoruesit nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në mikro-të dhënat, por me ligj studiuesit/hulumtuesit dhe institucionet mund të kërkojnë qasje përmes ASK-së.
9.5. Tjetër:	Të dhënat e AFP publikohen edhe në Vjetarin Statistikor të ASK. http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/te-pergjithshme/vjetaret-statistikor si dhe në Buletinin tremujor.
9.6. Dokumentacioni mbi metodologjinë:	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit paraqitet në publikimin e të dhënave: "Anketa e Fuqisë Punëtore TM2, 2017": http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-fuqise-punetore-ne-kosove-tm2-2017
9.7. Dokumentacioni për cilësi:	Asnjë vlerësim për cilësinë nuk është në dispozicion.
9.7.1. Shkalla e plotësisë për metadata	Nuk është në dispozicion.
9.7.2. Metadata - konsultime	Nuk është në dispozicion.

10. Kostoja dhe barra

3 anëtar punonjës në zyrën qendrore (1 udhëheqës i njësisë dhe 2 zyrtarë të lartë).

11. Konfidencialiteti

11.1. Konfidencialiteti - politika:	<p>"Agjencia do të sigurojë që të dhënat individuale të mbledhura për qëllime statistikore, të mbledhura nga persona fizikë ose juridikë, apo organet dhe organizatat e administratës publike (më tej "Responentët"), të trajtohen në mënyrë rreptësisht konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Ligji 04/L-036, Neni 34.</p> <p>"Të gjithë të anketuarit (responentët) janë të detyruar, në pajtim me ligjin në fuqi, të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë të dhëna në kohë dhe me saktësi statistikore në Agjenci, dhe të bashkëpunojnë me Agjencinë për të verifikuar saktësinë e të dhënave të mbledhura. LIGJI Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Neni 21: http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf.</p>
-------------------------------------	---

11.2. Konfidencialiteti - trajtimi
i të dhënave:

Qasja në të dhënat konfidenciale do t'u lejohet vetëm personave të cilët janë përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare deri në atë nivel që këto të dhëna janë të nevojshme për prodhimin e statistikave. Neni 37, Ligji Nr 04/L-036: <http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf>.

12. Komentimi Fillimi

